


DOKTORANTURË E PA MERITUAR!



Dr. Luftulla Peza

(Rreth doktoranturës: „ELEMENTËT GREKË NË GJUHËN SHQIPE DHE STATUSI I TYRE NË SHQIPEN MODERNE“ - përgatitur nga Juliana Kume, 2011, me të cilën ka fituar gradën shkencore „Doktor“ në Universitetin e Tiranës). Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Seit Mancaku.

Është bërë e zakonshme nga gjuhtarët në vendin tonë - ndërmarrja e studimeve të ndikimit të gjuhëve të huaja mbi gjuhën shqipe. Të tillë doktorantura janë kryer për ndikimet e greqishtes, latinishtes, persishtes, turqishtes, sllavishtes etj., mbi gjuhën shqipe. Ata janë njohtës profesionistë të gjuhës shqipe dhe për këtë punojnë, por dëshira i shtyn të hulumtojnë fjalë të ardhura nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe ose fjalët e huaja siç quhen ndryshe. Por, ndër kohë, asnjë studim nuk është ndërmarrë në Qendrën Albanologjike dhe katedrën e gjuhës shqipe në Fakultetin e Filologjisë mbi ndikimin e gjuhës shqipe në formimin e gjuhëve të tjera Indo-Europiane, megjithse këtë e njoftojnë mjaft dijetarë shqiptarë dhe të huaj.

Janë të shumta studime të tilla mbi ndikimin e gjuhës greke, latine, persiane, turke, të gjuhëve sllave etj., mbi gjuhën tonë amtare, gjuhën shqipe. Kjo e fundit ka ngelur jetime, sepse asnjëri nga studiuesit, nëpër institucionet shkencore shtetërore, nuk e vlerësojnë atë sa duhet, përveçse e njohin si gjuhë e re, që nuk ka dokumente shkrimore të vjetra dhe pa ndikim mbi gjuhët e tjera. Nga këto vlerësime të gabuara ata nuk e studiojnë ndikimin e saj mbi gjuhët e huaja.

Njëra nga çështjet më të rëndësishme në fushën time studimore prej shumë vitesh është pikërisht studimi i lashtësisë së gjuhës shqipe, rrënjëve të saj të lashta dhe lidhje me gjuhët më të lashta të njerëzimit. Megjithse është gjuha ime amtare dhe fjalët e saj janë të parat që kam belbëzuar në jetë dhe kam “bashkëbiseduar” me prindërit e mi, historia e saj përgjithësisht pak njihet, sepse studiuesit tanë të gjuhës

shqipe në katedrat dhe institutet e saj, nuk na kanë lënë studime të mirfillta mbi historinë e saj. Ata të gjithë e quajnë gjuhën shqipe të ardhur nga gjuha ilire, por që nuk ka paraqitur asnjë dokument të shkruar, pasi ilirët, sipas tyre, nuk e njihnin shkrimin, ishin analfabetë, gjë që nuk është e vërtetë. Ilirët, sipas shumë dokumenteve, e kanë zotëruar shkrimin të trashëguar nga të parët e tyre dhe kanë lënë për këtë shumë dokumente shkrimore, pak nga të cilët janë studiuar, që e vërtetojnë këtë plotësisht. Me qindra mbishkrime ilire flenë në Durrës, Apolloni dhe Butrint, nga të cilët vetëm një pjesë e vogël janë studiuar nga specialistët. Disa nga këta mbishkrime, të shekujve të fundit p.e.s. dhe të fillimit të erës sonë, janë falsifikuar nga disa studiues shqiptar dhe të huaj. Germat ilire në këta mbishkrime janë kthyer në germa të alfabetit grek dhe më pas mbishkrimet janë deklaruar si mbishkrime greke. Një shembull (Peza & Peza 2013. Dritë e re mbi pellazgët...):

Fjala mjaft e shpeshtë, që ndodhet në mbishkrimet e lashta pellazge dhe ilire është fjala **XAIPE**, e shkruar me germa e abecedarit pellazgo/ilir, që do të thotë HAJRE, HAJER, ME HAJER, PËR HAJËR, ashtu siç përdoret edhe sot në gjuhën letrare shqipe. Fjalori i gjuhës shqipe e ka këtë fjalë. Por V. Toçi (1972, 1986) këtë fjalë pellazge/ilire, të shkruar me germa pellazge/ilire, e kthen me germa të alfabetit të sotëm grek në këtë mënyrë: **XAIPE** fjalë ilire shkruar me germa ilire, kthehet në → **Χαίπευ** ose **χαίπε**, fjalë **ilire** shkruar me germa greke dhe më pas autori shkruan se këto janë mbishkrime në gjuhën greke!. Po kështu ky autor dhe autorja italiane Simone (1975, 1986) veprojnë edhe me mbishkrimin tjetër ilir të Durrësit: në të shkruhet **TATA XAIPE** = TATA (BABA) HAJER, për hajër, me hajër, ku të gjitha janë fjalë të njohura të gjuhës pellazge/ilire/shqipe. Ata në fillim e kthejnë mbishkrimin me germa greke: **Τάτα χαίπε** dhe më pas shkruajnë se mbishkrimi është në gjuhën greke!

Mbishkrimet ilire të Durrësit dhe Apollonisë janë falsifikuar edhe në një libër të botuar në Fracë mbi këto mbishkrime me autorë Cabanes, Haxhopulos dhe Faik Drini. Po përmend këtu si e kanë falsifikuar mbishkrimin ilir shkruar me germa pellazge/ilire:

Mbishkrimi ilir është: **FIMIA HIYNERON XAIPE**, këta falsifikatorë e kthejnë: → **SIMIA XIUVEPOV XAIPE** dhe më pas shkruajnë se mbishkrimi është në gjuhën greke.

Në këtë mënyrë janë falsifikuar qëllimisht ose nga niveli i pamjaftueshëm profesional mjaft mbishkrime ilire nga Durrësi dhe Apollonia etj., për të prerë lidhjen gjuhësore iliro/shqiptare dhe gjuhën shqipe për ta paraqitur gjuhë të re dhe të shkruar në mesjetë (Peza & Peza 2013, f. 36-37).

Nga ana tjetër vihet re se nga katedrat apo institute e gjuhë shqipe janë ndërmarrë mjaft studime, që bëjnë fjalë mbi ndikimet e gjuhëve të huaja sidomos greke, sllave, latine etj. mbi gjuhën

shqipe, ku vërehet tendenca gjithnjë e në rritje e shtimit të fjalëve, që i hiqen gjuhës shqipe për tju dhënë gjuhësve të huaja. Të krijohet përshtypja se gjuhtarët tanë, që kanë punuar ose punojnë në institucionet e gjuhës shqipe i kanë vënë vetes për detyrë të rrëmojnë sa më thellë, për ti hequr sa më shumë fjalë gjuhës shqipe, për ti paraqitur si fjalë të prejardhura nga gjuhët e huaja. Kështu gjuha shqipe po shkon drejt kolapsit, sepse një ditë nuk do të ketë fjalë të mjaftueshme të vetat për tu njohur nga bota si gjuhë më vete. Ja ç'thotë për këtë gjendje skandaloze studiuesi Niko Stillo.

Gazetari e pyet: **“Pse gjuhëtarët shqiptarë kanë vendosur për këtë gjuhë që e kemi, duke i përjashtur shumë fjalë nga fjalori i shqipes, duke e varfëruar në fakt leksikon e saj?”**

NIKO STYLO: “Unë isha para disa vitesh në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë në Prishtinë, në vitin 2010. Aty pati shumë referate për fjalët që gjuha shqipe ka marrë nga gjuhët e tjera, me të cilat ka pasur të bëjë. Një ditë një vajzë mbajti një kumtesë për turqizmat në gjuhën shqipe, dhe ajo tha se 25 apo 35 %, përqindjet nuk i mbaj mend saktësisht, të fjalëve në shqipen e sotme janë të huazuara nga turqishtja. Kumtuesja tjetër, atë ditë apo në ditën tjetër, nuk më kujtohet, u mor me greqizmat në shqipe. Edhe ajo tha pothuajse të njëjtat gjëra, shqipja ka marrë nga greqishtja kaq e kaq për qind fjalë, pra dikund rreth 30 %. Dikush tjetër u mor me sllavizmat, edhe ai tha se bëhet fjalë për një 20 % fjalë sllave në shqip. Pastaj një grua u mor me latinizmat e italianizmat në shqip, edhe ajo foli për përqindje të lartë të latinizmave, përkatësisht të italianizmave. Atëherë, unë thash se nëse ne do t'i llogarisnim këto përqindje, atëherë ne jemi në shifrën mbi 100% të fjalëve të huaja në shqip. Dhe kjo, në konsekuencën e fundit, do të thotë se ne nuk kemi një gjuhë tonën. Një grua që foli për latinizmat tha se fjala “i sigurt” “siguri” është një huazim nga italishtja. Unë i thash se unë jam nga Preveza dhe babai im nuk e ka njohur italishten se tek ne nuk ka pasur kurrë italianë dhe kur e pyesja për diçka se a është i sigurt, ai më thoshte: “Kio është si gur”, pra kjo është e sigurt. Babai im kur ishte i bindur për diçka thoshte “si gur” dhe jo “siguro” apo “sigura”. Referentja që foli për greqizmat e përmendi fjalën “tema” si fjalë greke. Unë i thash asaj se unë e njoh mjaft mirë gjuhën greke, sepse në këtë gjuhë jam shkolluar. Unë mund të lexoj dhe kuptoj edhe greqishten e vjetër, edhe atë që është shkruar p.sh. në vitin 400 apo 450 para Krishtit, kurse gjuha e Homerit dhe autorëve të tjerë që vijnë pas tij është edhe më e vështirë, pra unë e kuptoj mirë greqishten e vjetër dhe atë të re dhe në gjuhën greke kjo fjalë nuk ka kurrëfarë kuptimi. Pastaj, thash më tutje, grekët nuk thonë “tema”, por “thema”, kurse shqiptarët këtë fjalë e kanë marrë nga italianët dhe e shkruajnë si “tema” dhe jo si “thema”. Por kjo fjalë mund të shpjegohet me fjalën shqipe “thom” “them”. Studentët filluan të duartokasin. Pra, nuk është mirë që gjithçka të kërkojmë gjetkë, është më mirë që ta studiojmë më mirë dhe më thellë gjuhën tonë dhe atje do të gjejmë shumëçka, për të cilën nuk kemi besuar deri më tani, sepse më tepër ne iu kemi besuar teorive të atyre që i kanë zhdukur gjurmët e shkrimit shqip. Sepse shqipja është një gjuhë shumë e vjetër, ajo është gjuha jonike apo dorike. Gjuha jonike është më e vjetër se kultura greke dhe gjuha e saj. Kjo gjuhë ishte gjuha jonë në lashtësi”.

(Bisedën e zhvilloi: Xhevat Ukshini - Dhjetor 2013).

Kohët e fundit studiova me vemendje doktoranturën e zonjës Juliana Kume me titull: „Elementët grekë në gjuhën shqipe dhe statusi i tyre në shqipen moderne“, disertacion me të cilin ajo ka fituar gradën shkencore „Doktor“ në Universitetin e Tiranës.

Kam shumë vite, që merrem me historinë e lashtë të kombit tonë dhe me mbishkrimet e lashta dhe me gjuetinë e fjalëve shqipe në këto mbishkrime. Rezultatet janë të mahnitëshme: mbishkrimet e lashta janë të shkruara në gjuhën pellazge, sepse janë pellazgët ata, që ndërtnuan qytetërimin e parë botëror dhe shpikën shkrimin qysh gjatë neolitit dhe e zhvilluan më tej në kohrat më të vona. Mbishkrimi Dipylon i Athinës dhe ai i Korinthit (shek. 8 p.e.s.), i perkasin gjuhës pellazge/shqipe dhe jo greqishtes, siç i kanë trumbetuar (Peza & Peza, referuar në Kongresin I Ballkanik, Istanbul, 2012, Peza & Peza 2013).

Zonja Kume ka mbaruar Universitetin e Tiranës për filologji dhe gjuhë greke dhe për gjuhën shqipe me sa duket ka marrë vetëm formim të përgjithshëm.

Që në hyrje të punës së saj ajo na ven përpara botkuptimin e saj për dy gjuhët huadhënese dhe huamarrëse, që analizon:

“... njohja e gjuhës shqipe si gjuhë e dëshmuar me shkrim mjaft vonë nga njëra anë, njohja e saj si gjuhë e folur që nga kohrat më të errëta të prehistorisë, kjo dëshmuar me marrëdhëniet e gjata 3000 vjeçare me gjuhën greke, si dy gjuhët më të vjetra të Ballkanit..”

Ajo vazhdon: Shqipja dhe greqishtja janë gjuhët më të vjetra të Ballkanit. “Dëshmi e kësaj fqinjësie të gjatë historike kanë qenë elementët e greqishtes në gjuhën shqipe si dhe ndikimi i kulturës greke në vendin tonë” (f. 6).

Se nga janë vjelur këto të dhëna nuk shënohet, por këto nuk janë të vërteta, ato përbëjnë përcëmime për kulturën dhe gjuhën tonë super të lashtë pellazgo/ilire/shqipe dhe mbivlerësim të komshiut, pa asnjë bazë shkencore. Për gjuhë shqipe janë dhënë mjaft dokumente shkrimore të lashta pellazge, etruske, ilire etj., që e dëshmojnë atë të shkruar qysh gjatë kohës së bronzit nga punimet e Z. Krispi 1832, F. Adamidi 1902, I. Thomopoulos 1912,1913, Z. Majanit 1963, S. Konda 1964, N. Vlora-Falaski 2004, A. Kola 1995, M. Aref 2003, 2004, Peza 2006, Peza & Peza 2009, Mati 2010 etj. Është e çuditëshme si nuk i ka shfrytëzuar në punën e saj këto studime mjaft të rëndësishme mbi lashtësinë e gjuhës shqipe dhe nuk shkruan as një fjalë për to doktorantja që kërkon gradën shkencore Doktor i Shkencave për gjuhën shqipe.

Doktorantura kështu i bën jehonë të madhe gjuhës greke, si gjuhë mjaft e vjetër e folur dhe e shkruar, që i ka dhënë shumë fjalë gjuhës “fukareshë” shqipe, që nga kohrat parahistorike, gjatë mesjetës dhe vazhdon ti japë edhe gjatë ditëve tona.

Ja si shprehet Xh. Krispi (1832, 2009 në shqip), që mund të quhet me të drejtë babai i gjuhës shqipe, sepse i pari ka bërë një studim të plotë mbi gjuhën tonë. Ai shkruan:

“Duke gjurmuar origjinën e gjuhës greke, është një gjë e bukur të shohësh se si ajo të kthen , në pjesën e saj më të madhe, te shqipja. Si nuk u dashka pra të ngjallë një interes të madh kjo gjuhë, mbase më e lashtë se greqishtja dhe në thelb, gjuha me të cilën flitej në shekujt para Homerit..... Dardanët, frigët dhe pellazgët, pa dyshim më të lashtë se helenët, kishin të njëjtën gjuhë, gjurmët e së cilës vërehen sot te gjuha shqipe” (f. 12).

Autorja me pa të drejtë e ka injoruar këtë studiues të madh të gjuhës shqipe dhe të marrëdhënieve të saj me greqishten !!

Me këto që shkruar autorja vërteton se nuk e njeh mirë historinë e gjuhës greke dhe aq më tepër atë të gjuhës shqipe. Në historinë e Greqisë njihet një periudhë mjaft e rëndësishme kohore prej 6-7 shekujsh, emërtuar në shkencë si **Greek Dark Ages** (gjatë shekujve 11- 5 p.e.s.), gjatë së cilës nuk ndeshen dokumente kulturore ose shkrimore greke në ish Pelazgji, siç njihet rajoni i Egjeut dhe i Ballkanit në kohrat parahistorike (sipas Herodotit).

Veprat e para letrare europiane dhe perëndimore pranohen Iliada dhe Odisea e Homerit. Ja ç’na ofrojnë ato për gjuhën tonë: Në Iliadë dhe Odisea ende sot ndodhen qindra fjalë të gjuhës origjinale të lashtë pellazge, në të cilën u shkruan, që janë edhe në gjuhën shqipe sot.

ΙΛΙΑΣ Μηνιν Αειδης,	-Titulli dhe fjalët e para të këngës së parë të Iliadës, shkruar me gërmat e abecedarit pellazg: ILIAS = ILI AS = ILI ASHT = YLLI ASHT. Ili është emri i mbretit dardan, që e themeloi Trojën rreth vitit 3500 p.e.s. -Fjalët e para janë: MENIN AEIDHE = MENIN A JA DHE (THE)....
--------------------------------------	---

E njëjta gjë është edhe në poemën tjetër Odisea

<p>ΟΔΥΣΣΕΙΑ</p> <p>Ἄνδρα μοι ἔννεπε,</p>	<p>-Titulli dhe fjalët e para të këngës së parë të Odisesë, shkruar me gërmat pellazge janë: ODYSSEY = ODHËS, UDHËS, UDHËTAR.</p> <p>Fjalët e para: ANDRA MOJ ENNEPE = ANDËR MOJ NEPE, JEPE</p>
---	---

Siç shihet titulli dhe fjalët e fillimit të këngës së parë të Iliadës dhe Odisesë së Homerit janë në gjuhën pellazge me kuptim të njejtë në gjuhën e sotme shqipe dhe janë shkruar me abecedarin pellazg, i vetmi i njohur në atë kohë. Nga studiues të tjerë në këto vepra janë gjetur edhe shumë fjalë të tjera të gjuhës pellazge/shqipe.

Shihni sa bukur fjalët e gjuhës së lashtë pellazge janë në përdorim edhe sot në gjuhën shqipe. Më të drejtë në enciklopedinë Wikipedia shkruhet:

“Fjala helenë, që do të përkthehej si grekë, nuk është përdorur nga Homeri”. Homeri dhe Hesiodi, dy poetët me të cilët fillon letërsia europiane, nuk i kanë njohur grekët, sepse gjatë shekullit 8 p.e.s., kur ata kanë jetuar dhe u formulua Iliada, Odisea dhe veprat e tjera nga gojdhënat popullore, fiset greke ende nuk kishin ardhur në rajonin e Egjeu.

Një gjë të tillë e mbështet edhe Thusididi (469-395 p.e.s.), i cili në librin “Lufta e Peloponezit” shkruan: *“...prova ime më e madhe për këtë është vetë Homeri, i cili edhe përse ishte i kohëve shumë më të vona se Lufta e Trojës, ai sërish nuk e përmendi emrin grekë në veprën e tij”.*

Kjo vërtetohet edhe nga arkeologjia: Në Trojë zbuluesi i saj ka shkruar se nuk gjinden dokumente të kulturës greke para shekullit 5 p.e.s. Ja si shkruan Shlimani 1976, f. 268:

*“Qeramika greke ishte e pikturuar, kurse ajo trojane jo. Kjo e fundit ndryshonte edhe në formë edhe në mjeshtri edhe në ngjyra. Prania e gjurmëve greke në Trojë mund të vihet re vetëm qindra vjet pas epokës së Homerit. Në të shtatë shtresat e hershme nuk gjendet asnjë dëshmi e kulturës greke. Madje nuk gjindet as edhe një gjurmë e qeramikës helene më e vjetër se e shekullit të V p.e.s.”*¹

Arkeologët e kanë ndarë Qytetërimin Trojan në tri pjesë kryesore:

- 1-TROJA I-VII, që kapin periudhën 3500-1000 p.e.s., përbëjnë qytetërimin më të vjetër dhe të pa emërtuar, po sipash shumë dijetarëve përbën Qytetërimin Pellazg,
- 2-TROJA VIII, 600-85 p.e.s., koha greke (këtu përfshihet edhe periudha e Perandorisë Maqedone e Aleksandrit të Madhe, si dhe periudha e pushtimit persian),
- 3-TROJA IX, 85 p.e.s.-500 era jonë koha romake.

Të njëjtën gjë kanë theksuar arkeologët në gërmimet arkeologjike në ishullin e Lemnit, që nuk kanë takuar elementë grekë para shekullit 5 p.e.s. (Prokopio & Smith 1964). Ndërsa arkeologu anglez A. Evans, autor i zbulimit të Qytetërimin Minaik të Kretës, të gjitha objektet kulturore dhe shkrimore të këtij qytetërimi i quan paragreke.

Nga këto të dhëna arrijmë në përfundim tjetër, ndryshe nga ato që shkruhen në doktoranturën e zonjës Juliana: gjuha shqipe e ka vulën e vet në Iliadë dhe Odise, veprat etrare më të vjetra europiane, formuluar gjatë shekullit 8 p.e.s., ndërsa grekët as që përmenden në Iliadë dhe Odise. Kjo vërtetohet edhe nga arkeologjia.

Prandaj kur diskutohet për vjetërsinë e popujve dhe të gjuhëve këto të dhëna të rëndësishme duhet të kihen parasysh: deri në shekullin e 5 p.e.s. në Ballkan dhe Egje ka zotëruar Qytetërimi Pellazg dhe gjuha pellazge, grekë e nisin rrugëtimin e tyre në histori vetëm në shekullin e parë p.e.s. kur marrin emrin nga romakët.

Krahasuar me këto të dhëna baza e doktoranturës së zonjës Kume është

¹ O.Rexhep, 2012, f. 154

ndërtuar mbrapsh dhe pa asnjë mbështesë shkencore.

Autorja në punimin e saj të doktoranturës është mbështetur kryesisht në tre burime kryesore: fjalori etimologjik i gjuhës shqipe i G. Meyerit, disertacioni i G. Ulischit mbi huazimet greke në gjuhën shqipe (1962) dhe studimet etimologjike të E. Çabejt në disa vëllime. Të gjitha këto punime i përkasin fillimeve dhe mesit të shekullit të kaluar. Janë shfrytëzuar edhe studime të tjera në këtë fushë, që trajtojnë huazimet greke në gjuhën shqipe: punimet e S. Mansakut, J. Gjinari, Thomait, Dh. Qiriazit, Orellit etj. që të gjithë që i bëjnë jehonë gjuhës greke si gjuhë huadhënëse për gjuhën shqipe.

Bie në sy, që nuk është shfrytëzuar asnjë vepër shkencore, që i bën jehonë gjuhës shqipe, si gjuha më e vjetër europiane, që paraqesin dokumente shkrimore për lashtësinë e saj, dhe që ka ndihmuar në formimin e gjuhëve të tjera greke dhe latine, përmendur më sipër.

Disa autorë të huaj që e njohin greqishten dhe që merren me studimin e gjuhëve europiane, kanë gjetur në gjuhën greke mijëra fjalë, që nuk gjejnë shpjegim në gjuhën greke dhe ata mendojnë se këto fjalë janë huazuar në gjuhën greke nga një gjuhë e huaj më e vjetër.

Kush është ky popull më i vjetër se grekët? Homeri, Hesiodi, Herodoti dhe shkrimtarë të tjerë të lashtësisë përmenden pellazgët, “Zeusin Pellazgjik”, “Perënditë pellazge të Olimpfit”. Këto vërtetohen më pas nga autorët e vjetër dhe modern në gjuhësi, arkeologji etj.

Këtë grumbull fjalësh, që janë me mijëra, ata e kanë veçuar më vete dhe e kanë emërtuar “Pre-Greek substrat in the Greek language” ose “Pelagian substrate in the Greek language” (pra substrati ose nënshtesa paragreke ose pellazge në gjuhën greke). Me këtë problem janë marrë shumë autor, ne mund të përmendim: A. Fournet, Renfrew 1998, Beekes 2003, 2009, 2010, Finkelberg 2006, Hajnal, Brown 1985 etj.

Fjalët e huazuara në gjuhën greke nga gjuha para-greke janë klasifikuar në disa kategori (Renfrew 1998): **-emërtime kafshësh:** volinth-os, vonant-os-dem i egër; tmiuth-os (mouse)-miu etj.; **-emërtime arkitektonike:** labyrinth-os-labyrinth; plinth-os – tullë; pyrg-os – (tower) –kullë, pirg; pergamos etj., **-terma detarie:** thalass-a –deti etj.; **-instrumenta muzikor:** turius- flaut, kitharis-kitare, salpius-trumpeta, formiys-lyra etj.; **-emra personash:** Odisseus (Beekes 2009). Por këtu mund të shtojmë edhe emra të tjerë nga Iliada dhe Odisea e Homerit: Priam, Hektor, Akile, Aleksander, Agamemnon, Anea etj.; **-emërtime bimësh:** elaia – ulliri, kissos – urthi, ampelos- hardhia etj.; **-emërtime metalesh dhe metalurgjia:** kassiteros- kallaj, halkos –bronz, molivos-plumb, sidiros- hekuri etj.; **-emërtime sociale:** tiranos- prijës absolut, tiran, etj.; **-emra perëndishë:** Apollo, Apollon (Beekes 2003). Plus kësaj të gjitha emrat e perëndive të Olimpfit, që përmenden në Iliadë, Odise dhe në epikat e Hesiodit, trashëgohen nga gjuha paragreke: Zeus, Hera, Poseidoni, Hadesi, Athena, Apollo, Artemis, Afrodita, Thetis, Dionisi etj.; **-emra vendesh:** Korinthos, Zakynthos, Parnas etj.(Renfrew 1998); **-lloje të kultivuara:** elaion –vaj ulliri, oinos- vera, likythos- enë vaji, kanthon-pack-ass etj.; **-emërtime armësh:** tivuni-heshtë gjuetije, ussos-ushta, shtiza, thoras-etj.; **-emra, që lidhen me endjen:** murinthos-kordon, spango, gjalm; aruvallos-rrudh, mbledh, hiton-tunikë etj.

Përveç këtyre kategorive të huazimeve para-greke në gjuhën greke është edhe një kategori tjetër, e pa njohur: emrat njerzish të kohës sonë, që kanë ardhë nga lashtësia.

Fiset greke kur erdhën në rajoni e Egjeut, që atëhere quhej Pellasgjia, siç na njofton Herodoti, nuk kishin emër, por më vonë nga romakët morën emrin

“graekoi”, grekë.

Paraqisin një listë të shkurtër vetëm me emrat e qeveritarëve të sotëm greke, që kanë emra të huazuar nga populli para-grek, emra që nuk shpjegohen me anë të gjuhës greke, por që gjejnë shpjegimin e plotë në gjuhën shqipe, e cila e ka origjinën tek gjuha e popullit të lashtë para-grek, pellazgët. Këtyre emrave po tu heqës prapastresën greke –os, dalin që janë emra me origjinë të lashtë pellazge.

Presidenti grek quhej **Papulias**, po ti heqim prapashtesën bëhet = pa pula a, d.m.th. është pa pula; kryeministri grek **Aleksandër Tsipras**, ka emër dhe mbiemër shqiptar: Aleksander = a lek s(i) andër = asht le si në andër, T zi pras = t zi pras, pras i zi. Kështu me rallë janë edhe emrat e ministrave të tjerë grekë: **Kotzias** = kot zi asht; P. **Koroumplis** = ka ro m(e) plis= që rron me plis (qeleshe); P. **Kammenos** = ka men os = ka men osht, që ka mend është etj.

Mjaft nga këto fjalë dhe emra kuptohen shumë lehtë nëpërmjet gjuhës shqipe. Kjo trego se ato vijnë nga një gjuhë e lashtë, që ka pasur lidhje të ngushta me gjuhën shqipe, por është më e vjetër se ajo. Kjo është gjuha pellazge, sepse sipas shkrimtarëve të lashtë banorët më të vjetër të Ballkanit dhe rajonit të Egjeut, para ardhjes ë grekëve, kanë qenë pellazgët. Kështu gjuha e tyre është më e vjetër se gjuha greke.

Në kapitullin I- Rrugët e depërtimit të greqizimave në gjuhën shqipe, ku jepen, sipas autores, mjaft fjalë greke, që kanë hyrë në gjuhën shqipe. Përmenden mjaft fjalë, që pa ndonjë bazë shkencore quhen greke dhe të huazuara në gjuhën shqipe, si: *dhomë, livadh, lango, lexoj, dritare, qytet, qendër, pazar, lakën, gomar, tjegull, ilaç, flas, falenderoj, shalqi, çudi, kufi* etj.

Qytet-shtetet e kohës së bronzit i themeluan pellazgo/shqiptarët dhe si mund të vijë kjo fjalë nga greqishtja, kur grekët nuk njiheshin në atë kohë?

Kriteri shkencor për të njohur se kujt gjuhe i përket një fjalë e caktuar është shpjegimi, krahasimi i saj në gjuhët e mundëshme. Kjo nuk bëhet në doktoranturë. Ajo që bën autorja është një proces i thjeshtë mekanik, që i merr një sasi fjalësh nga diku dhe i fut në gjuhën tjetër pa bazë. Fjalët *dhomë, drit-are, pa-zar, falem-nderoj, ku-fi* etj. gjejnë shpjegim në gjuhën shqipe dhe jo në greqisht. Në doktoranturë nuk jepet asnjë shpjegim.

Në kapitullin II-Elementët e greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe, shkruhet se “*Greqishtja është e dokumentuar me shkrim nga shekulli 14-13 p.e.s. dhe është më e vjetër se sa sanskritishtja ndërsa gjuha shqipe me dokumentin e shekullit 15*” (!!!). Autorja nuk jep asnjë citim literature, ku janë marrë këto të dhëna. Po cila është kjo “gjuhë e vjetër greke”, që autorja e ngren kaq lart?

Gjatë kohës antike u ngritën mbretëritë maqedone, ilire, thrake, epirote, dake etj. dhe nga gjuha pellazge u formuluan gjuhët ilire, maqedone, epirote, thrake, dake etj., por ajo që ka marrë emrin “gjuha e vjetër greke”, përbëhet nga fjalë të gjuhës më të vjetër pellazge, që nuk mund të quhet se i përket greqishtes (Peza 2006, Peza & Peza 2009, 2013).

Ja një fjalor i shkurtër i fjalëve të “gjuhës së vjetër greke”, krahasuar me ato shqipe moderne dhe greke moderne: vihet re që fjalët e asaj që quhet greqishte e vjetër janë njësos si në gjuhën shqipe dhe nuk ngjajnë fare me fjalët në greqishten moderne. Kjo tregon se ajo që quhet “gjuhë e vjetër greke” nuk është gjë tjetër por “gjuhë e vjetër shqipe” (pellazgjishte).


English:	Albanian:	Ancient Greek:	Modern Greek
Curse	nëm	nëm	katara
Yet	anda ënda	andha	efkaristis
Field	arë	arura	horafi
Together	bashkë	vask	porevume
Sea	deti	theti	thalasa
Land	dhe dheu	dhor, dha	ji
Wood	dru	dris	ksilo
And	edhe dhe	idhe	qe
Dark	errët	ere-vos	skotos
Chills	ethe	ethir	piretos
Talk	flas	flio	milao
Breath	fryma	frimao	fisima
Ran	iki	iki	fevgo
Horse	kalë	kelis-tos	alogo
Harvest	korr	kir	thiro
	krua	krunos	vrisi
Head	kri, krye	krithen	qefalo
Born	leh, lind	leh	jenieme
Rabbit	lepur	leporis	lagaes
Wool	lesh	lesios	mala
Wicked	lig	ligos	adhinatos
	loz	lizo	pezo
Pray	lutem	litome	parakalo

Kështu kursesi nuk mund të quajmë këto fjalë “të gjuhës greke” !!, që paskan ndikuar në gjuhën shqipe, por e kundërta gjuha pellazge/shqipe ndikoi për tu formuar dhe shkruar gjuha greke.


Të gjitha të dhëna hedhin dritë mbi atë që gjuha shqipe është e shkruar shumë shekuj më parë se gjuha greke dhe nga kjo nuk ka sesi lashtësia e saj të njihet nëpërmjet gjuhës greke, siç pretendon autorja, gjë që përbën mosnjohje të thellë në problematikën e studiuar dhe gabim të rëndë.

Por autorja le të japë një dokument të shkruar të gjuhës greke para shekullit të 5 p.e.s. Nuk ka. Ndërsa dokumentet e shqipes, në trajtën e saj më të vjetër, pellazgjishte, janë shumë të lashta, që e vërtetojnë, se është më e lashtë në botë. Ja shembuj:

1-Mishkrimi i Vinkës (mijëvjeçari 6 p.e.s.). Mbishkrimi është prova më e lashtë e qenies së gjuhës pellazge, nga rrjedh gjuha shqipe (Peza & Peza 2012). Kultura e Vinkës përhapet në jugë të Danubit (Serbi, Kosovë, Kroaci, Shqipëri, Hungari, Rumani, Greqi e veriut). Në këtë enë balte të Vinkës janë gërvishur fjalat VIJV=UJIU = UJI dhe numrat III dhe 1.

PELLAZGJISHT	SHQIP	ANGLISHT
 = IIIVIJV1 = UJIU dhe numrat III dhe 1	=UJ, UJI dhe numrat III, 1	Water and the numbers III, 1

2-Mbishkrimi Tartaria (mijëvj. 6 p.e.s.), mbishkrimi është gjetur në Rumani dhe përbën njërin nga dokumente më të vjetra, që vërtetojnë praninë e gjuhës pellazge/shqipe të shkruar.

PELLAZGJISHT	SHQIP	ANGLISHT
 = P, Dor	P, Dor, Dora	The letter P, Hand


Fjalët UJI dhe Dor, gjerat V, I, J, P, D, o, r si dhe numrat I, II, III, III dhe 1 përbëjnë fjalët dhe numrat më të vjetër të shkruara ndonjë herë në botë dhe këto i

përkasin gjuhës pellazge, gjuha më e vjetër europiane, si dhe germat e alfabetit pellazg, më i lashtë europian (Peza & Peza 2012, 2013). Shumë fjalë të gjuhës pellazge/shqipe ndodhen në shkrimin Linear B të Mikenës (shek.14-12 p.e.s.) edhe në Stelën e Lemnit (shekulli 9-8 p.e.s.) (Peza & Peza 2012, 2013).

Iliada dhe Odisea, formuluar gjatë shek. 8 p.e.s., përmendur më sipër.

Mjaft fjalë të gjuhës pellazge në epikat e Homerit kanë gjetur edhe Krispi,1831, Adamidi 1906, Shneider (2009), A. Kola (2002), Peza & Peza (2006, 2009, 2013), Boçi (2012) etj.

Prandaj prania e fjalëve të gjuhës pellazge në Iliadë dhe Odise, të njejta si në gjuhën e sotme shqipe, tregon se këto vepra janë trashëgimi pellazge dhe jo greke dhe gjuha shqipe është shkruar më heret se gjuha greke.

 <p data-bbox="199 1142 606 1176">FIMIA XIYNERON XAIRE</p>	<p>Ky është mbishkrimi ilir nga Apollonia, shek. 3 p.e.s. FIMIA XIYNERON XAIRE= = Fëmia ka shkuar në yje, tek zoti, i qoftë për hajër. Përveç mbishkrimit kjo hinore ose arkivol ka edhe një kryq të madh. Ky kryq ilir, rrjedh nga pellazgët dhe nga ilirët u huazua nga kristianët, ku lindi bersimi kristian në fillim të erës sonë. Edhe fjala JEZUS është huazuar nga pellazgo/ilirët, ja sesi: ZEUS →JE ZEUS= JE ZeUS= JEZUS</p>
--	--

Më poshtë autorja J. Kume vazhdon:

“Nga të gjitha gjuhët e dëshmuara të Europës, greqishtja është gjuha më e vjetër me një shtrirje kohore prej 3500 vjetësh. Të njëjtën gjë kemi edhe për shqipen, pavarësisht nga shkaqet historike, nuk ka trashëguar dëshmi të shkruara”. Lashtësia e popullit shqiptar dhe e gjuhës shqipe provohet nëpërmjet gjurmëve të hershme të ndërtimit grek në leksikon dhe strukturën e gjuhës shqipe” !!! (f. 25). Këto që shkruan autorja nuk janë të vërteta dhe për këtë nuk jep asnjë autor që ti ketë shkruar, përveç atyre, që falsifikojnë historinë. Shumë dokumente për këtë i paraqitëm më sipër, nga rezultatet e arkeologjisë në Trojë, ishullin e Lemnit, ishullin e Kretës, Thesali etj., ku nuk vëretohën dokumente greke para shekullit 5 p.e.s. Shlimani, zbuluesi i Trojës e ka bërë të qartë më 1976, p. 268). Si është e mundur që doktorantja na jep informacion të shtrembët për këto probleme të rëndësishme?

Më poshtë autorja rendit mjaft fjalët të huazuara nga greqishtja në gjuhën shqipe: lakën, mokër (të marra nga Çabej), qershi, pras, shpellë, shkarpë, drapën, pjepër, shkop, molla etj. (të marra nga Mansaku). Prof. bullgar V.I.Georgiev 1977 në librin e tij “Trakia i teknijat ezik”, Sofie, sjell një “Pelagian glossary” të shkrimtarit të vjetër Hesihios, me fjalë pellazge (përkthyer në gjuhën angleze). Në këtë fjalor përmendet edhe fjala “derapne” = drapni i sotëm, balios = i bardhë etj. Kjo vërteton se fjala drapën, por edhe shumë të tjera janë fjalë pellazge/shqipe dhe jo greke,

Autorja analizon më pas në nënkapituj të veçantë elementët grekë në gjuhën shqipe të sjella nga G. Meyer, elementët grekë nga disertacioni i G. Ullschit, elementi i greqizmeve nga E. Çabej etj. Përveç lëvdatave autorja asnjë vërejtje ose

plotësim nuk shënohet për këto studime, të bëra një qind ose pesëdhjetë vjet më parë.

Në nënkapitullin “Njësi leksikore greqizma”, ku përmenden si greke fjalët: *dimiq, efendi, kalem, kanun, kamba* etj. Fjala DIMIQ = DY MIQ, KALEM/LAPIS = KA LEM= KA LINDUR, LAPIS = LA PIS, sespe len bojën, KAMBA, përmendet nga Krispi dhe gjindet në shkrimet e lashta i fjalë e pellazgishte/shqipes. Këto fjalë shpjegohen vetëm me gjuhën shqipe, që tregon se autorja nuk i ka studiuar mirë.

Vijojnë nënkapitujt “Njësi leksikore me huazime të dyanshme”, “Greqizma nga periudha mesjetare”, “Klasifikimi i greqizmave të E. Çabej”, “Greqizma tek autorët e vjetër”, “Greqizma në ligjërimin e shqipes së Greqisë” etj., në të cilat jepen mjaft fjalë, që mendohet se janë të huazuara nga gjuhët e huaja: *pirun, flamur, dhomë, astrit, gomar, ishull* etj.

Fjalër e mësipërme duhet ti përkasin shqipes, sepse gjejnë shpjegimin tek ajo: *dimiq-di, dy miq*, për dy këmbët e dimiqve, *kalem = ka lem, ka lindur, kamba= ka m ba, pra “ka (forcë) dhe më mban”, flamur= f la mur; astrit =asht rit; ishull= ish uj, kthyer në ishull*. Fjalën “*piruna*” e kemi ndeshur në gjuhën hitite bashkë me shumë fjalë të tjera të ngjajshme me ato shqipe, shek. 16 p.e.s.. Jam i bindur se në asnjë gjuhë tjetër këto fjalë nuk gjejnë shpjegim. Shumë fjalë nga këto i përmend Krispi (Shqipja nëna e gjuhëve, 1831), që nuk është shfrytëzuar nga autorja.

Kapitull i rëndësishëm është “Njësi leksikore me burim grek në gjuhën standarte shqipe” krahasuar me fjalori i gjuhës shqipe 1980 (f. 149-157). Gjatë shtjellitimit shumë fjalë nga ky fjalor njihen si fjalë të gjuhës greke: *aguridhe, Anadoll, fjalë nga greqishtja futur në gjuhën turke nga erdhi në gjuhën shqipe, andrallë, argat, astrit, dimiq, kamat, kandil, magji, mokër, pagan, pirun, barkë, agoni*. Nga fjalori i gjuhës shqipe rreth 700 fjalë janë cilësuar që i përkasin gjuhës greke, bërë kjo pa asnjë studim, por thjeshtë mekanikisht. Këtu përfshihen shumë fjalë, që shpjegohen vetëm me gjuhën shqipe: fjala *andra* dhe *andrallë* vijnë nga Odisea, por edhe fjalët *argat=ar gat*, gatitës i arës, *kamat=ka mat*, që mat, *kandil* si dhe fjala *mendil = ka n dil, ka (dritë, vaj) prandaj dil, mendil =mend dil* etj. Padrejtësisht nga autorja fjalët i hiqen shqipes dhe i jepen greqishtes, pa asnjë studim.

Ka edhe disa kapituj e nënkapituj mbi greqizmat në gjuhën shqipe, të ndara në kategori të ndryshme si greqima në emërtimin e kafshëve, greqizma pas vitit 1990 etj.

Mendoj se autorja duhet të kishte studiuar autorët, që flasin mbi atë që është quajtur nënshtresa (substrati) para-greke në gjuhën greke, që ti kuptonte renditjen e fjalëve.

Disa autorë duke u marrë me problemet e gjuhëve të rajonit të Egjeut dhe të Mesdheut kanë arritur në përfundimin se në gjuhën greke, ekziston një nënshtresë apo substrat para-grek fjalësh të lashta, që janë huazuar në gjuhën greke nga një gjuhë paragreke. Substrati apo nënshtresa para-greke përbën një gjuhë të pa njohur, por të folur në kohrat parahistorike në atë që quhet Greqi, para vendosjes së folësve të greqishtes në rajon. Sipas këtyre autorëve gjuha greke ka huazuar disa mijëra fjalë, emra vendesh, perëndishë, sendesh etj. nga kjo gjuhë më e vjetër dhe fjalori i gjuhës greke këto fjalë nuk i shpjegon dot. Disa autorë këtë nënshtresë e kanë quajtur “Pelagian pre-Greek substrat”.

Kjo nënshtresë me fjalë dhe terma para-grek në gjuhën greke ka rëndësi të madhe për problemin që analizojmë, prandaj do ta shtjellojmë më gjërë dhe në detaje. Bëhet fjalë për një sasi fjalësh dhe emërtime, që nuk i përkasin gjuhës greke, por një gjuhë më të hershme para-greke. Këto janë me mijëra fjalë dhe terma, emra të ndryshëm, bimësh, sendesh dhe perëndishë etj., që kanë hyrë dhe janë trashëguar nga gjuha më e lashtë para-greke në gjuhën më të re greke.

Fjalët e huazuara në gjuhën greke nga gjuha para-greke janë klasifikuar në

disa kategori (Renfrew 1998), paraqitur më sipër.

Për substratin para-grek në gjuhën greke shkruajnë edhe autorë të tjerë Beekes 2003, 2009, 2010, Finkelberg 2006, Hajnal, Brown 1985 etj. Edhe I. Thomopoulo (1912) njofton për praninë e shumë fjalëve të gjuhës pellazge/shqipe në gjuhën qipriote.

Beeks (2010) përmend se në të shkuarën substrati para-grek ka qenë njohur si “Pelagian” dhe përfaqësonte një dialekt Indo-Europian.

Në përfundimet e doktoranturës së saj zonja Juliana Kume thekson:

“Duke qenë se studimi konsiston në nxjerrjen dhe inventariimin e greqizimeve nga veprat e G. Mejerit, disertacioni i G. Ulichit dhe studimet etimologjike të E. Çabejt... mendoj se kam kontribuar sadopak në trajtimin e kësaj teme të gjërë dhe të bukur dhe që na ofron shumë për të hulumtuar, studiuar dhe konkretizuar ndikimin leksikor e morfologjik të greqishtes së re në gjuhën shqipe. Ky punim është vetëm fillimi, shkëndijëza e ideve të reja të një pune të gjatë, të cilën do të kem mundësi ta thelloj në të ardhme”(f. 261). Kështu Juliana Kume angazhohet ti thellojë edhe më tej në të ardhme mjaft nga gabimet e saj të rënda në doktoranturën e paraqitur.

Disa vërejtje:

1-Mendoj se dhënia e një teme të tillë për doktoranturë, që të nxiren greqizmat nga veprat e Mejerit, Çabejt apo Ulichit nuk është punë për doktoranturë. Nuk mund të lejohet fitimi i doktoranturës vetëm me kaq, të nxerrim çfar duam nga veprat më të vjetra për ti paraqitur si të mirqena, pa asnjë vërejtje. Do të ishte me vend një analizë e imët e këtyre veprave nën dritën e arritjeve të reja të shkencës. Analizë e tillë nuk është bërë. Asnjë vlerësim kritik për punimet që analizohen në doktoranturë për veprat e Mejerit, Ulichit, Çabejt etj. dhe asnjë kritikë shkencore nuk ka në doktoranturë.

2- Në doktoranturë, nëpër kapitujt e ndryshëm, mjaft fjalë të gjuhës shqipe cilësohen si fjalë të gjuhës greke pa asnjë kriter shkencor dhe bindës. Fjalët e dhëna e kanë shpjegimin në gjuhën shqipe dhe nuk kanë shpjegim në gjuhën greke. P.sh. si i kemi përmendur më sipër.

3-Për një përfundim të mbarë të studimit autorja duhet të kishte shfrytëzuar mjaft studime me vletë të madhe për gjuhën shqipe. Libri i Krispit “Shqipja nëna e gjuhëve” (1831) nxjerr në pah mjaft fjalë të lashta të marra nga Iliada e Homerit dhe autorë të tjerë antikë, që janë të gjuhës shqipe. Ai ka ndërtuar fjalorin e parë pellazgisht/shqip dhe duhet të ishte baza e studimit. Studimi i F. Adhamidhit “Pellazgët dhe pasardhësit e tyre shqiptarët” (1902), në të cilin autori bën paralelizime midis pellazgishtes /shqipes, greqishtes, latinishtes dhe sanskritishtes dhe fjalët i quan të gjuhës shqipe. Me rëndësi janë edhe veprat e I.Thomopolos, arvanitas që i shkruar në greqisht (1912, 1913), ku trajtohen mjaft mbishkrime të lashta nga Greqia, Anadulli dhe Mesdheu dhe të gjitha autori i shpjegon me ndihmën e gjuhës shqipe. Studimet mbi nënshtresën para greke në gjuhën greke duhet të shërbenin si bazë e rëndësishme për doktoranturës.

4-Detyra e doktorantit është të sjellë të reja të vlefshme për shkencën në doktoranturën e paraqitur, gjë që nuk vihet re në doktoranturën e Juliana Kumes. Asnjë gjë e re nuk sillet, që ti shërbejë gjuhës shqipe dhe studiusve të saj.

5.Udhëheqsi shkencor dhe oponentët nuk e kanë kryer detyrën e tyre, por janë mjaftuar me sa duket me fjalë të përgjithëshme dhe lëvdata. Doktoranturë me këtë nivel të ulët nuk duhet të kishte kaluar shkallët e mbrojtjes. Si përfundim mendoj:

1-Tema e doktoranturës është trajtuar jo e plotë, nuk ka vështrim kritik mbi punën e bërë nga studiuesit e mëparëshëm për këtë problem, por mjaftohet vetëm me përmendjen ose sjelljen e mendimeve të autorëve të tyre. Mundon kritika shkencore.

2-Nuk janë shfrytëzuar burime themelore të literaturës, që trajtojnë temën e lashtësisë së gjuhës shqipe dhe lidhjen e saj me gjuhët e lashta sanskrite, greke, latine.

3-Lidhur me përkufizimet që jepen mbi gjuhën shqipe, sidomos vjetërsinë e saj, autorja nisat nga disa postulate dhe jo mbi faktet reale. Nga kjo autorja paraqitet se ka njohuri mjaft të cekta dhe të vjetra dhe të dala jashtë loje, mbi historinë dhe vjetërsinë e gjuhës shqipe. Kjo vjen si pasojë e mos shfrytëzimit të literaturës shkencore për problemin.

4-Përzjedhja e fjalëve për ti hequr nga gjuha shqipe dhe për ti futur në gjuhën greke është bërë vetëm mekanikisht, pa asnjë bazë shkencore. Po të ishin analizuar ato si duhet mbi baza shkencore në krahasim me literaturën përkatëse, gjendja do të ishte krejt ndryshe.

5-Me qenë që autorja njeh mirë greqishten dhe shiqpen e ka amtare, me një punë të kujdesshme dhe duke bërë krahasimet në përputhje me literaturën mbi substratin paragrek në gjuhën greke, mund të japë kontribut të madh dhe mund ti sjellë dobi të madhe gjuhës shqipe dhe gjuhësisë europiane, duke e pasuruar me fjalë që asaj i kanë humbur gjatë historisë, por që ruhen si të huazuara në gjuhën greke. Autorën e huaj i kanë gjetur këto fjalë si të huaja për/në gjuhën greke, por nuk dinë ku ti fusin, sepse nuk e njohin gjuhën shqipe dhe nuk e dinë, që ajo është vazhdimi i gjuhës pellazge, nga ka ardhë substrati para grek në gjuhën greke.

6-Nuk sillet asgjë e re për problemin që trajtohet në doktoranturën e zonjës Juliana Kume.

Nga puna jo e mjaftueshme me shfrytëzimin e pakët të burimeve dhe me gatimin e lëndës përfundimet e doktoranturës së zonjës Kume janë pa asnjë rezultat konkret, pa sjellë asnjë dobi, por i sjell dëm të madh gjuhës shqipe, duke i marrë fjalët e saj, për ti a dhënë greqishtes.

Si përfundim mendoj se doktorantura e zonjës Kume është e pa arrirë, nuk ka rezultate, e varfëron pa të drejtë gjuhën tonë amtare, duke i hequr asaj shumë fjalë pa kritere shkencore.

Mendoj që doktorantura duhet të ripunohet dhe të paraqitet për mbrojtje në një komision të ri, të ngritur nga universiteti i Tiranës dhe me oponentura të reja.

Udhëheqsi shkencor i kësaj doktoranture të pa arrirë nuk e ka kryer detyrën, që ta udhëheqë drejtë doktoranten. Ai nuk duhet ta kishte lejuar të përfundonte kjo doktoranturë dhe po ta kishte kryer ai detyrën në lartësinë e duhur do të kishim një doktoranturë të saktë të zonjës Juliana Kume. Prandaj udhëheqsi shkencor të kthejë shpërblimin e marrë për mos kryerjen e detyrës.

Është e domosdoshme të hapen katedra (departmente) të gjuhëve të lashtë të Ballkanit dhe Anadollit.

Sidomos është e domosdoshme vemendje e posaçme të kushtohet në dy drejtime themelor:

1-Të studiohet gjuhës ilire, të parët tanë më të afërt, që pranohen nga gjuhtarët dhe historianë tanë, por që gabimisht mendohet se “nuk kanë lënë dokumente shkrimore”. Dokumente shkrimore ilire ka me shumicë në muzeta tanë, kryesisht në Durrës, Apolloni dhe Butrint, por aspak të studiuar.

2-Iliada dhe Odisea të Homerit janë pranuar si veprat letrare më të vjetra europiane të ruajtura nga lashtësia, me një ndikim shumë të madh në mendësinë (të menduarit) dhe ndërgjegjen europiane. Prania e fjalëve shqipe në të dyja këto vepra tregojnë se janë njëkohësisht edhe veprat më të vjetra të letërsisë shqipe dhe që kanë lajtur rol të rëndësishëm për rilindjen tonë kombëtare. Prandaj përkthimi i saj i parë në gjuhën shqipe u bë në vitin 1896 nga rilindësi dhe poeti ynë i madh Naim Frashëri. Për deri sa në këto vepra ndodhen fjalët e para të shkruara të gjuhës

shqipe, ato duhet të pranohen zyrtarisht si dokumenti i parë i shkruar i gjuhës shqipe dhe ta lemë në qetësi “Formulën e Pagëzimit”, si dokument i gjuhës shqipe i mesjetës.

Kjo oponentë ju dërgua ministres së arsimit z. Besa Shahini dhe rektorit të Universitetit të Tiranës Prof. Dr. Mynyr Koni.

PËRZGJEDHJE NGA BURIMET:

Diodorus Silicus, Library of History, book, III, 67

Herodoti, Historia

Adamidi F. 1902. Les pelasges et leur descendants les Albanais. L. Institut Egyptien Quatrieme series, Ar. 3, Cairo 1903

Arredu, A.G. 2007. Le origini albanesi della civiltà in Sardegna.

Beekes, R.S.P. 2010. The pre-greek loanwords in Greek. Etymological dictionary of Greek. Brill

Brown R. A. 1985. Evidence for pre-greek speech on the Crete from Greek alphabetic sources. A.M. Hakkert, 1985, 408 pp.

Green J.K. 1916. Leaving the Levant. The Pilgrim Press, Boston, New York, Chicago

Fournet A. – The Pelasgian Pre-Greek substratum and Linear A.

Izzo, Herbert J. 1972. Tuscan and Etruscan: the problem of linguistic substratum influence in Central Italy. Toronto. University of Toronto Press, VI, pp. 238

Xhak 1995. Shqiptarët.

Katapano G. 2007. Thoti fliste shqip, Tiranë

Krahe H. 1962. Die Struktur der alteuropäische Hydronymie. Akademie der Wissenschaften und Literatur. Abhandlungen des Geistes und Sozialwissenschaftliche Klasse, Jahrgang 1962, nrë 5, pp.287-341

Kretschmer P. 1896. Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache. Göttingen

Krispi Xh. 1831. Shqipja nëna e gjuhëve, Tiranë 2004

Mati I. 2010. Stela e Lemnit. Shtëp. Bot. Librit Shkollor e Re, Tiranë

Peza L. 2006. Shkrimi më i hershëm i shqipes. Gaz. Republika 17 qershor 2006

Peza L. & Peza L. 2009, 2013. Dritë e re mbi pellazgët dhe gjuhën e tyre. Tiranë

Prokopio A., E. Smith 1964. Athens: City of the gods from prehistory to 338 B.C. New York: Stein and Day,

Shuke A. 2009. Shumerianët dhe shqipja zanafilla e identitetit kombëtar. Gazeta Republika 26.10.2009

Vlora-Falski N. 2004. Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët, Prishtinë

Me respekt

Luftulla Peza



Golem-Pragë, më 10 korrik 2019

Prof., Doc., RNDr. Luftulla H. PEZA, CSc., DrSc.

ADR;HOME: Voronezská 7;101 00 Praha 10;Prague;CZ;Czech Republic

TEL;CELL;VOICE:00420-607570072

EMAIL;PREF;INTERNET:luftulla.peza@gmail.com

ADR; HOME: Kompleksi T.I.D, Pall. G/2, Rruga Fan Noli, Golem, Kavajë, Al, Albania

TEL;CELL;VOICE:00355-0676492998

REV:20060114T030515Z

END:VCARD